

## LIGJI Nr. 22/2018 “PËR STREHIMIN SOCIAL”

**Akti më i rëndësishëm për realizimin efektiv të programeve sociale të strehimit për viktimat e dhunës;**

**Një hap i mëtejshëm për përmbushjen e standardeve të Konventës së Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”**

Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”, i cili është akti më i rëndësishëm për realizimin e programeve sociale të strehimit, që përbën edhe qëllimin e natyrshëm të tij.

Duke përshëndetur miratimin e këtij ligji, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) dëshiron të theksojë rëndësinë e tij për sanksionimin e shërbimeve mbështetëse të strehimit, për gratë viktimat të dhunës.

Gjithashtu, QNL shpreh kënaqësinë e saj që edhe në këtë rast, Kuvendi i Shqipërisë ka trajtuar me vëmendje dhe ka reflektuar në ligj, sugjerime të paraqitura nga organizata të shoqërisë civile gjatë procesit të konsultimit për projektligjin e paraqitur në Kuvend. Si rezultat i bashkëpunimit tonë me Kuvendin procesit të konsultimeve, ligji ka reflektuar standarde të reja ndërkombëtare që i paraprijnë përmbushjes së detyrimeve të shtetit shqiptar për mbrojtjen dhe mbështetjen e shtresave sociale, e në mënyrë të veçantë viktimave të dhunës.

Konkretisht, nga sugjerimet që QNL dërgoi në vëmendje të Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në datën 07.02.2018, ky i fundit, ka mbajtur parasysh dhe ka reflektuar në ligj disa prej tyre. Në radhë të parë, ato që lidhen me zbatimin e standardeve të vendosura nga *Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”*. Një nga detyrimet që buron nga kjo Konventë Evropiane për shtetet anëtare, është marrja e masave të nevojshme për të garantuar që viktimat të kenë akses në shërbime të tilla si strehimi, i cili është një nga shërbimet kryesore mbështetëse për to (neni 20 i Konventës).

Duke referuar kuptimin “*Viktimë e dhunës në familje*”, si të njëjtin kuptim siç përkufizohet në ligjin nr. 104/2012 “*Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”* (neni 2/46), ligji ka zgjeruar dhe forcuar mbështetjen për kategoritë e viktimave të parashikuara nga kjo Konventë.

Konkretisht, ligji ka parashikuar si përfituese të këtij shërbimi tre kategori të grave e vajzave të dhunuara (shih: neni 2, pikat 46, 47, 48, si dhe neni 43, pika 1/f/g

<https://www.parlament.al/akt/ligj-nr-222018-per-strehimin-social/>):

1. Viktimat e dhunës në familje;
2. Viktimat e trafikimit;
3. Viktima të mundshme të trafikimit;

QNL e konsideron këtë fakt si një arritje të rëndësishme të ligjit, por shpreh besimin se në një të ardhme jo të largët, edhe kategoritë e viktimave të formave të tjera të dhunës, jo medoemos të dhunuara në familje, të përfshihen në këtë ligj si përfituese të shërbimeve të strehimit, sipas detyrimeve të Konventës.

QNL e konsideron si një përmirësim të përmbajtjes së ligjit në këndvështrimin gjinor, reflektimin në nenin 29 pika 4 të tij, ku është pranuar që çdo pjesëtar i familjes të deklarojë vetë të ardhurat e veta dhe jo përmes Kryefamiljarit, sikurse ishte parashikuar në projekt.

Zbatimi i standardeve ndërkombëtare është një prioritet i punës sonë në zbatim të projektit “Ngritja e një rrjeti të organizatave jofitimprurëse për një zbatim më të mirë të standardeve ndërkombëtare mbi barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore në Shqipëri”- në kuadër të programit rajonal, “Zbatojmë Standartet, Ndryshojmë Mendësitë”, të financuar nga Komisioni European dhe zbatuar nga UN Women.